



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË**

Nr. 640 prot.

Tiranë, më 05.02.2021

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. 248 prot.

Tiranë, më 05.02.2021

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**“Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale  
të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm”**

**TË VETËDIJSHËM:**

Për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkeljet individuale të magjistratëve, prokurorë, në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm, nëpërmjet ushtrimit dhe zbatimit të praktikave më të mira në çështjet disiplinore për rritjen e performancës së sistemit të drejtësisë penale;

**NISUR NGA:**

Fakti se procedimi disiplinor është në funksion dhe duhet t'i shërbejë llogaridhënia dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve prokurorë dhe nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive si një mjet për të cenuar pavarësinë dhe autonominë e prokurorëve;

**ME SYNIM:**

Rritjen e bashkëpunimit të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) me Prokurorinë e Përgjithshme (PP), në kryerjen e inspektimeve tematike e institucionale dhe/ose për shkelje individuale në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm.

**DUKE RIAFIRMUAR:**

Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës dhe ligjeve gjatë proceseve respektive të punës së të dy institucioneve, ku inicimi dhe zhvillimi i hetimit disiplinor të realizohet në ekilibër, midis parimeve të interesit publik për administrimin e drejtësisë, respektimit të të drejtave të individëve, parimit të ligjshmërisë,

gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, si dhe atij të ndarjes së pushteteve.

**NË MBËSHTETJE TË:**

-Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, neni 204 pika 1 shkronjat “a” e “b” e vijues;

-Ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 shkronjat “ë” dhe “i” e vijues;

-Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , neni 119 e vijues;

**ME PALË NËNSHKRUUESE:**

**Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,**

**dhe**

**Prokuroria e Përgjithshme (PP), përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Z. Olsian Çela, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,**

**të cilat:**

**bien dakord për Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si më poshtë:**

Neni 1  
**Objektivi**

1. Sigurimi i bashkëpunimit në procesin disiplinor ndaj prokurorëve të gjithë niveleve dhe inspektimin tematik e institucional të prokurorive me juridiksim të përgjithshëm, përmes realizimin e funksioneve dhe përgjegjësive kushtetuese e ligjore të palëve, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënie, transparencës, procesit të rregullt ligjor dhe të eficencës të sistemit të drejtësisë penale.

2. Vendosja e komunikimeve të drejtpërdrejta për shkëmbimin e informacionit, pa cënuar diskrecionin e njëra-tjetrës, sekretin hetimor dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të Palëve në këtë Marrëveshje.

Neni 2  
**Kontributi i Prokurorisë**

1. Prokurori i Përgjithshëm, depoziton kërkesë pranë ILD-së përmes hetimin e shkeljes individuale disiplinore, në rastet kur ka të dhëna të besueshme se është kryer shkelje disiplinore, e konstatuar nëpërmjet:

- mbikëqyrjes/monitorimit të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme;
- informacione periodike mbi ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë;

c) kryerjes së analizave e raporteve lidhur me securinë e veprimitarise së prokurorive me juridikcion të përgjithshëm;

ç) informacione nga institucion e burime të tjera.

2. Kërkesës i bashkëlidhet dokumentacioni i nevojshëm lidhur me faktet, indicet dhe provat që kanë shërbyer për të besuar se është kryer një shkelje disiplinore.

3. Prokurori i Përgjithshëm, kérkon kryerjen e inspektiveve institucionale e tematike në një apo disa prokurori nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke parashtruar në kérkesë nevojën e inspektimit, problematikat e konstatuara dhe sugjeruar objektin e inspektimit, sipas rastit.

4. Prokurori i Përgjithshëm siguron bashkëpunimin e prokurorive me juridikcion të përgjithshëm me ILD-në, për të lehtesar procesin e marrjes së informacionit dhe ushtrimit të funksioneve nga inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

5. Prokurori i Përgjithshëm vë në dijeni ILD-në lidhur me informacionin i cili ka të bëjë me procedimin disiplinor të magjistratëve, prokurorë, i siguruar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 3

#### **Kontributi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm për çdo vendim për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Prokuror si dhe për kryerjen e inspektimit tematike apo institucional .

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm lidhur me rezultatet e inspektiveve tematike apo institucionale, të këruara nga Prokurori i Përgjithshëm në përputhje me ligjin.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkëpunon me Prokurorin e Përgjithshëm në kuadër të sigurimit të informacionit gjatë ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tij ligjore.

Neni 4

#### **Kontribute të përbashkëta**

1. Palët marrin përsipër për të bashkëpunuar lidhur me transmetimin e memories institucionale për kryerjen e inspektiveve institucionale apo tematike në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm.

2. Palët marrim përsipër që të organizojnë takime të përbashkëta dhe shkëmbejnë eksperienca ndërmjet inspektorëve të ILD-së dhe prokurorëve me përvojë në fushën e inspektimit dhe hetimeve disiplinore në Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe adresimin e problematikës së hasur gjatë inspektiveve të bëra nga ana e ILD-së.

Neni 5

#### **Koordinimi ndërmjet Palëve**

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.

- Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje.
- Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 6  
**Konfidencialiteti**

Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.

Neni 7  
**Dispozita të fundit**

- Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët.
- Ndryshime mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- Për sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njofuar paraprakisht, me shkrim, palën tjetër.
- Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe dy të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme.

Kjo marrëveshje u nënshkrua sot, më datën 05/02 2021.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**ARTUR METANI**



**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

